



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 05.09.2016

Ref.: 780/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:

- Prodhimtari dhe Automatizëm, MSc, 120 ECTS, (me specializime: Teknologjia e Prodhimtarisë ; Automatizimi i proceseve prodhuese);
- Sistemet e Energjisë së Ripërtritshme, BSc, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit Prodhimtari dhe Automatizëm, MSc, 120 ECTS, dhe Sistemet e Energjisë së ripërtritshme, BSc, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1.	Prodhimtari dhe Automatizëm	MSc	120	Agron Pajaziti, Shaban Shabani, Gani Pllana
2.	Sistemet e Energjisë së Ripërtritshme	BSc	180	Jonuz Bunjaku, Xhemajl Fejzullahu, Shaban Buza

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 31.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Herwig Grogger, Prof. Dr. Tauno Otto, Prof. Dr. Peter Sturm, Prof. Dr. Reijo Tuokko, Mr. Dionis Martinskevichus.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 25 gusht 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi. Pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik, KSHC ka konstatuar që këto dy programe të studimit nuk i përmbushin kushtet për akreditim, dhe me këtë rast KSHC merr vendim negativ për ri/akreditimin e këtyre programeve të studimit.

Për programin e studimit Prodhimtari dhe Automatizëm, MSc, 120 ECTS, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka paraqitur si bartës të programit këta tre profesor, Prof. Dr. Agron Pajaziti, Prof. Dr. Shaban Shabani, Prof. Dr. Gani Pllana. Pas verifikimit të dokumentacionit nga AKA të bartësve të programit të studimit është konstatuar që Prof. Dr. Shaban Shabani është në moshën e pensionimit (67 vjeç), dhe për këtë arsyeje nuk mund të trajtohet si staf i rregullt (nuk ka kontratë të rregullt pune), sipas Ligjit të Punës, neni 67, pika 1.4.

Për programin e studimit Sistemet e Energjisë së Ripërtitshme, BSc, 180 ECTS, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka paraqitur si bartës të programit këta tre profesor, Prof. Dr. Jonuz Bunjaku, Prof. Dr. Xhemajl Fejzullahu, Prof. Dr. Shaban Buza. Pas verifikimit të dokumentacionit nga AKA të bartësve të programit të studimit është konstatuar që asnjëri nga tre bartësit e prezantuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike nuk është në marrëdhënie të rregullt pune në këtë program të studimit, përkatësisht në këtë fakultet.

- Prof.Dr. Jonuz Bunjaku ka dorëzuar deklaratë më shkrim në AKA me të cilën ka konfirmuar se ka marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" (deklarata e datës 16.11.2015). Gjithashtu ka dorëzuar edhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetin të Gjakovës "Fehmi Agani" për zgjedhjen e tij në pozitën e Prorektorit për buxhet dhe financa (vendimi nr.01/2574, datë. 04.11.2015). Andaj duke u bazuar në këto fakte, Prof. Dr. Jonuz Bunjaku nuk mund të trajtohet si staf i rregullt në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.
- Prof. Dr. Xhemajl Fejzullahu, pas verifikimit të dokumentacionit nga AKA të bartësve të programit të studimit është konstatuar që është në moshën e pensionimit (66 vjeç), dhe për këtë arsye nuk mund të trajtohet si staf i rregullt (nuk ka kontratë të rregullt pune), sipas Ligjit të Punës, neni 67, pika 1.4.
- Prof.Dr. Shaban Buza ka dorëzuar deklaratë më shkrim në AKA me të cilën ka konfirmuar se ka marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" (deklarata me datë 15.10.2015). Gjithashtu ka dorëzuar edhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universitetin të Gjakovës "Fehmi Agani" për zgjedhjen e tij në pozitën e Rektorit të Universitetin të Gjakovës "Fehmi Agani" (vendimi nr.01/2428, datë. 09.10.2015). Andaj duke u bazuar në këto fakte, Prof.Dr. Shaban Buza nuk mund të pranohet si staf i rregullt në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, dhe fakteve të prezantuara më sipër, KSHC ka konstatuar që këto dy programe të studimit nuk i përmbushin kushtet për akreditim, dhe më këtë rast KSHC marr vendim për mos akreditim të këtyre dy programeve të studimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë